



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
JURIA

Prot. 477/11

07.07
Tiranë ___..2022

Vendim nr. 40 datë 07.07.2022

**Për dhënien e mirënjohjes “Nderi i Akademisë” shkrimtarit,
studiuesit dhe përkthyesit Dhimitër Pasko / Mitrush Kuteli
(Pas vdekjes)**

Referuar nenit 10 të Rregullores për çmimet shkencore që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe për mënyrën e organizimit të konkurseve të tyre;

Në mbështetje të Vendimit të Kryesisë nr. 19 datë 24 mars 2022 Për mirënjohjen “Nderi i Akademisë” dhe për kriteret dhe procedurat e dhënies së saj;

Me propozim të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike; Juria, në mbledhjen e saj të datës 07.07.2022,

Vendosi:

1. T’i jepet mirënjohja Nderi i Akademisë shkrimtarit, studiuesit dhe përkthyesit Dhimitër Pasko / Mitrush Kuteli (pas vdekjes), me këtë motivacion:

Shkrimtar me veprimtari krijuese origjinale në prozë dhe poezi; një ndër themeluesit kryesorë të prozës moderne shqiptare; mjeshtër i ligjërimit e rrëfimit, fantazisë dhe së magjishmes; krijues e rikrijues virtuoz mbi bazën e motiveve tradicionale të botës shqiptare; shqipëruer i kryeveprave botërore dhe pasurues i gjuhës shqipe; publicist e mendimtar kritik; studiues me vepra të suksesshme në disa fusha të dijes; veprimtar gjurmëlënës në rrugën e përparimit shoqëror e qytetar të vendit.

2. Mirënjohja *Nderi i Akademisë* të dorëzohet me një ceremoni publike të organizuar sipas përshkrimit në *Rregulloren për ceremonialin dhe solemnitetet*, në veprimtarinë e parashikuar në nderim të 115-vjetorit të lindjes së tij më 8 korrik 2022;

3. Ngarkohen sekretari shkencor dhe kancelari për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI

KRYETAR

